

GJL nr.104//2012

DPK/DMP

03-860/2012

07

02-03-2012

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve: Ragip Namani kryetar, Dalip Bega dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e sek. juridike Ganimete Dumani, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga i pandehuri Sreten Ivanoviq, nga fsh. Turiqevac Komuna e Novobërdës, kundër aktvendimit të Gjykatës komunale për kundërvajtje në Prishtinë, Regj.I.nr.24909/2011, të dt. 23.12.2011 e në bazë të neneve 31 al.3, 39 dhe 222 të Ligjit për kundërvajtjet, më 01.02.2012, nxjerr:

A K T V E N D I M

Ankesa e paraqitur është e **BAZUAR**.

ABROGOHET aktvendimi i Gjykatës komunale për kundërvajtje në Prishtinë, Regj.I.nr.24909/2011, i dt 23.12.2011, dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në plotësim të procedurës dhe rivendosje.

Nga një kopje e këtij aktvendimi u dorëzohet palëve.

A r s y e t i m

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, me aktvendimin Regj.I.nr.24909/2011, të dt.23.12.2011 të pandehurin Sreten Ivanoviq, nga fsh. Turiqevac K e Novobërdës e ka shpallë përgjegjës:sepse si Drejtor i Administratës së Përgjithshme në Komunën e Novobërdës nuk e ka bërë deklarinimin e pasurisë pranë Agjencionit Kundër Korrupsionit në afatin e caktuar ligjor edhe pse ka qenë i njoftuar se është përfshirë në listën e zyrtarëve të cilët janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë, me ç, veprim ka bërë kundërvajtje nga neni 6 pika 2 lidhur me nenin 16 par. 1 pika 2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publikë, për të cilën Kundërvajtje ia shqiptoi gjobën në shumë prej 800€. Me të njëjtin aktvendim i pandehuri është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5€.

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur i pandehuri Sreten Ivanoviq, për shkak të cenimit qenësor të dispozitave të procedurës kundërvajtjese, vërtetimit të gabuar dhe jo plotë të gjendjes faktike si dhe vendimit mbi dënim në arsyetim ndër të tjera thekson: se vepra kundërvajtjese në kohën e parashtrimit të kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtjese, për kundërvajtjen e cila i ngarkohet nuk ekziston ose kërkesa në kohën e parashtrimit të saj ka qenë e parakohshme ose kjo kërkesë në kohën e paraqitjes dhe zhvillimit të procedurës kundërvajtjese është jo ligjore, sepse në atë kohë ka pushuar baza ligjore dhe kushti për ndjekjen eventuale për kundërvajtjen e kryer më herët, se kërkesa ndaj tij është parashtruar në gjykatë më 14.07.2011, dhe se në këtë kohë ka qenë në detyrë tjetër dhe atë Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës,se më datë 11.03.2011, është shkarkuar nga posti i Zyrtarit të Lartë të Komunës së Novobërdës, ku ka qenë i obliguar të lajmëroi pasurinë dhe me këtë shkarkim ka pushuar baza ligjore që të jetë i ndjekur si kryes i kundërvajtjes e cila i vihet në barrë, andaj nga këto fakte mendon se gjykata e shkallës së parë ka qenë dashur ta refuzoi kërkesën e Agjencionit për shkak se kundërvajtja e cila i vihet në barrë nuk paraqet kundërvajtje, se pasurinë e tij si Deputet i Kuvendit të Kosovës e ka lajmëruar më datën 06.06.2011, dhe se nuk ka pasur qëllim të

/...

2.

kryej kundërvajtjen e cila është e përshkruar si në dispozitivin e aktvendimit të goditur, se ky obligimin ligjor e ka kryer kur ka paraqitur pasurinë më datë 06.06.2011, para se Agjencioni të parashtrori kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtjese ndaj tij më datë 19.07.2011, andaj nga të lartcekurat propozon që aktvendimi i goditur nga Gjykata e Lartë për kundërvajtje të ndryshohet dhe të refuzohet kërkesa ndaj tij për fillimin e procedurës kundërvajtjese, ose ky të lirohet nga dënimi ose ti shqiptohet dënimi minimal apo më kusht ose aktvendimi i njëjtë të abrogohet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kolegji vlerësoi thëniet në ankesën e parashtruar aktvendimin e goditur deklaratën e të pandehurit të dhënë në gjykatën e shkallës së parë si dhe shkresat tjera nga lënda dhe konstatoi se ankesa e paraqitur është e bazuar, ndërsa aktvendimin e goditur e abrogoi dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kolegji konstatoi se dispozitivi i aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, është jo i plotë sepse nuk përmban llojin e deklaramit të pasurisë ashtu siç është e paraparë në nenin 5 ku ekzistojnë katër lloje të deklaramit, (por ceket vetëm neni 6 i Ligjit), e gjithashtu nuk dihet koha e kryerjes së kundërvajtjes përkatësisht periudha raportuese për deklaramit të pasurisë në datë, muaj apo vit. Këto lëshime janë edhe në kërkesën e parashtruesit të kërkesës. Gjykata e shkallës së parë është dashur ti mënjanoi dhe sqaroi këto lëshime gjatë zhvillimit të procedurës kundërvajtjese me parashtruesin e kërkesës.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e zhvillimit të procedurës kundërvajtjese nuk e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, nuk i ka administruar në tërësi provat e nevojshme, për nxjerrjen e një aktvendimi të bazuar në Ligj dhe fakte. Nga shkresat e lëndës, deklaratës së të pandehurit dhe vendimit nga Zyra e Kryetarit të Komunës së Novobërdës, konstatohet se i pandehuri më datë 11.03.2011, është shkarkuar nga detyra e Drejtorit të Administratës së Përgjithshme, sepse i njëjti është zgjedhur Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, andaj nga ky fakt rezulton se i pandehuri para datës 31. Mars 2011 (ende pa e mbushur 1 vit) është shkarkuar nga detyra dhe nuk dihet se prej kur është në atë detyrë ndërsa në bazë të nenit 6.1 të Ligjit për Deklarimin e Pasurisë të Zyrtarit të Lartë Publikë deklarimi bëhet gjatë kohës së punës në shërbimin publikë.

Kolegji po ashtu vlerëson se në rastin konkret pasi i pandehuri është shkarkuar nga funksioni zyrtar, Agjencioni Kundër Korrupsion në rastin konkret ka mundur të veproi në bazë të nenit 9 të njëjtit Ligj për Deklarim të pasurisë pas largimit nga funksioni, e në lidhje me nenin 5.4 të njëjtit Ligj.

Është fakt se i pandehuri si Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më datë 02.06.2011, në Agjencinë Kundër Korrupsion i është lëshuar vërtetim me nr. 03-2862/2011, i datës së njëjtë nga i cili shihet se i pandehuri ka bërë deklaramin e pasurisë si Deputet Popullor, ndërsa pas këtij deklarimi të pasurisë më datë 14.07.2011, ndaj tij ushtrohet kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtjese në Gjykatën për Kundërvajtje në Prishtinë për mos deklarim të pasurisë nga i pandehuri në kohën gjersa ka qenë Zyrtar

/...

3.

në Komunën e Novobërdës ku këtë post siç e cekëm më lartë e ka dorëzuar më datë 11.03.2011, gjithashtu aktvendimi i shkallës së parë është kualifikuar në dispozitën sanksionuese neni 16. para. 1 pika 2 e cila ka të bëjë mos deklaram të pasurisë me rastin e marrjes së detyrës, andaj nga të lartcekurat aktvendimi si i tillë nuk mund të qëndroi por duhet të bëhet plotësimi i procedurës.

Në plotësimin e procedurës gjykata e shkallës së parë për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike duhet të veprim sipas vërejtjeve dhe konstatimeve të gjetura nga Kolegji dhe të ndërmerri këto veprime procedurale; të merr në pyetje në cilësinë e dëshmitarit përfaqësuesin e Agjencionit kundër korrupsionit për tu sqaruar rreth kërkesës së tyre pasi që në kërkesë nuk ceken faktet e dëshmuara në gjykatë dhe në ankesën e të pandehurit, po ashtu të deklarohet rreth bazës ligjore për veprën kundërvajtjese të cilën ia ngarkojnë të pandehurit dhe kohën e kryerjes së kundërvajtjes e nëse ngarkohet për mos deklaram të rregullt vjetor, atëherë i pandehuri para mbushjes së 1 viti është shkarkuar nga detyra dhe si Zyrtar i Lartë ka bërë deklaramin e pasurisë më datë 02.06.2011, si Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa kërkesa ndaj tij është parashtruar më datë 14.07.2011. Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave të cekura më lartë e sipas nevojë të administroi edhe prova shtesë dhe pas vërtetimit të gjendjes faktike të nxjerrë aktvendim të drejtë të bazuar në prova dhe Ligj.

Nga të lartcekurat konform të nenit 222 të LMK u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË,

GJLnr.104/2012, dt. 01.02.2012.

SEK. JURIDIKE
Ganimete Dumani




KRYETARI I KOLEGJIT

Ragip Namani,

Ragip Namani